



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas/Gllogoc
Kuvendi i Komunës



Nr. 02.060-16910 dt. 07.04 2023

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Milaim Hajdari, me dt. 13.04.2023 (E Enjte) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 17.03.2023, prot. 02-060/04-15371, dt. 30.03.2023.
2. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga Projekt nr. 10/611/850010/300/53732/0820, Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport;
3. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake .
4. Të ndryshme.

Drenas, 07.04.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari
Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr.- 060/04-15371 dt. 30/03/ 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **17.03.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 16.02.2023.
2. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.
3. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikëtove të Vjetër dhe Gillogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, theksoi se kemi edhe tri pika shtesë për rend dite: 1. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc, i plotësuar. 2. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit, i plotësuar. 3. Propozim vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera. pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës se bashku me këto tri pika shtesë, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan unanimisht rendin e ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 16.02.2023.**

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, komisioni kur te fillon ka me i shqyrtu gjitha kërkesat dhe duhet me dal në teren gjithsesi.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit.**

Nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale në zonën kadastrale në Çikëtove të Vjetër dhe Glllogoc, për projektin e rregullimit të ngrohtores së qytetit të Drenasit.**

Arbër Halilaj, duke pas parasysh rëndësinë e këtij projekti, dhe duke shikuar këtë propozim vendim mendoj se ekziston një projekt ideor që e kemi përmend që sdi sa kohë, jam në parim që qyteti ta ketë ngrohoren e vet, ndërsa sa i përket çështjeve tjera do t'i diskutojmë në mbledhje të rregullt.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne jemi përfitues të planit ose fizibilitetit për ngrohtore të qytetit, jemi në mesin e 7 komunave, prej vitit 2017 kemi pas memorandum, pasi që fizibiliteti është bërë nga ai komision dhe ata i kanë paraparë të paktën dy vende ku mund të vendosin ngrohtoren që kërkohet 6 Hektar e gjysmë dhe është një zonë shumë strategjike të cilën ka kërkuar komisioni që ne t'ia mundësojmë atyre me pas për nevojat të qëllimit të vendosje të ngrohtores së qytetit të Drenasit. Kjo pjesë është tek Feronikeli tek lagjja "Feronikeli" dhe i ka karakteristikat e veta sepse e ka edhe sistemin e ujësjellësit sepse duhet shumë uji i ngrohtë dhe ka me u bë një lloj liqeni të cilin duhet, ne me ligj e kemi për obligim me shpall zonë me interes të përgjithshëm, ne e kemi obligim me i dërgu tri parcela dhe ata e përzgjedhin dhe pasi të kalon në kuvend ne e kemi për obligim ligjor më ia dërgu MAPL-së.

Afrim Prokshi-zyrtar, neve na ka ardh edhe një draft propozim i fizibilitetit e kemi shqyrtuar dhe, i kanë propozuar dy vende mirëpo më i përshtatshëm është tek lagjja "Feronikeli" dhe tani janë në fazën përfundimtare të hartimit të planit të vlerësimit në mjedis në kuadër të atij rajoni, mirëpo duhet të behët ndërrimi i disa parcelave duhet të shndërrohet në pronë komunale, me u marrë nga Feronikeli sepse është njëra ndër lokacionet me të mira të mundshme, është edhe Iber Lepenci afër që mundet me u mbush me ujë liqeni dhe mund të marrin ujë të ngrohtë nga Feronikeli kur të lëshohet në prodhim, dhe kanë me u vendos kolektorët solar edhe për ngrohje të ujit mirëpo njëkohësisht edhe për prodhimin e energjisë që nevojitet për shtyrjen e ujit të ngrohtë deri të shpenzuesi deri në qendër të qytetit. Fizibiliteti përfshin qendrën e qytetit në një të afërme si opsion e kanë lënë edhe pjesën e Zabelit të ulet dhe Korreticës së ulet varësisht prej kapacitetit që do t'i vendosim, është një ndër metodat më të reja që po përdoret në Kosovë për herë të parë.

Florentina Elezi-Veliu, parimisht e përkrahi këtë propozim vendim sepse është shumë e nevojshme që me u bë rregullimi i ngrohtores së qytetit, i kemi para nesh tri propozime, ju e potencuat që propozimi i tretë tek pronat e Feronikelit është më i favorshëm, por çka ndodh nëse Feronikeli nuk pajtohet, e nëse ne e votojmë atëherë kthehemi prapë në fillim, apo nëse nuk pajtohet a i bien që kanë me u shtu me shumë investime, dhe nëse pajtohet Feronikeli, për sa vite ka me u realizua ky projekt?

Afrim Prokshi-zyrtar, është drafti i fizibilitetit dhe ende nuk është përfundimtar mirëpo krejt kjo punë varet derisa të vendoset zona, se në momentin që ndryshon zona atëherë ndryshon edhe burimi i energjisë më nuk do të jetë me kolektor solar po duhet me u bazu në ndonjë energji tjetër dhe në këtë kontest ndryshon edhe kostoja e projektit, ky projekt nuk realizohet me buxhet të komunës mirëpo komisioni evropian në kuadër të ministrisë ka ndarë 100 milion euro dhe ato fonde në momentin kur të kryhet fizibiliteti dhe merr formën përfundimtare dhe votohet edhe në kuvend komunal, dhe ne duhet me bë kërkesë në kuadër të ministrisë të ekonomisë dhe ata me ato projekte shpallin tender ndërkombëtar, dhe me shumë se dy vite nuk mundet me shku realizimi i këtij projekti sepse duhet të bëhen edhe kanalet dhe infrastruktura e brendshme neper qytet.

Hamit Haxhiu, para dhjete viteve është fol që do të bëhet ngrohtorja e qytetit dhe besoj se ka pas fizibilitet, draft paraprakisht a ka ndonjë ndryshim prej atyre projekteve më herët?

Afrim Prokshi-zyrtar, ne që dy vite jemi si grup punues në kuadër të kuvendit çdo të dhënë që e kanë kërkuar, me krahasua me draftin që e ceke me herët nuk e kam shikuar at draft, ndërsa fizibiliteti që është duke u hartuar tani nga komisioni evropian në bashkëpunim me Giz-in gjerman ka një qasje tjetër, burimi i energjisë ndërron dhe dallon shumë nga ai me

herët, e kane parapare që burimet e energjisë të jenë burime të ripërtërihem, panele solare me kolektor solar dallon shumë nga ai i mëparshmi. Na kanë kërkuar që me ia caktu një parcelë që atë parcelë që mundën me përdor a mundemi me e kthi në pronë komunale për me e shfrytëzua atë pronë për implementimin e këtij projekti.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:
5. Propozim vendim për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc, i plotësuar.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për vënien në diskutim publik e rregullores për Bonuset e Zonimit, i plotësuar.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për vlerësimin e Dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Të ndryshme.**

Hamit Haxhiu, propozoi që të rishikoni se a kompensohen anëtarët e Komisionit Komunal të aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale Pastrimi.

Arbër Halilaj, Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendësdrejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, komisioni prej sa anëtareve përbehet?

Muhamet Gjoka- Drejtor i Arsimit, në bazë të udhëzimit administrativ e cek që komisioni përbehet nga dy propozimet që vijnë nga DKA-ja dhe një nga këshilli i prindërve, dmth komisioni përbehet prej 3 anëtareve.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:50 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVES

KOMUNA E DRENASIT

Zyra e Kryetarit

Nr. 01-400/01-16822

Drenas, më 07.04.2023



Në vështrim të nenit 58 paragrafi 1, nën(h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Kryetari i Komunës së Drenasit propozon:

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2.Pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën _____ 2023 të miratoj këtë:

PROPOZIM – VENDIM

Për transfer të mjeteve nga Projekti nr 10/611/850010/300/53732/0820 Kategoria e Shpenzimeve Kapitale në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 në buxhetin e drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport:

Neni 1

Me këtë Propozim –Vendim, miratohet transferi i mjeteve në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale nga projekti nr 10/611/850010/300/53732/0820 ‘Ndërtimi i qendrave multifunksionale (Shtëpi e Kulturës: Muze, Arkiv, Bibliotekë,Teatër,Salla Filmi, Galeria e Arteve)Glllogoc, Tërstenik,Komaran” në Projektin nr 10/611/850010/300/89114/0820 Objekte Sportive Stadioni i Qytetit- Faza e dytë, në programin buxhetor të Drejtoratit për Kulturë,Rini dhe Sport.

Neni 2

Transferi i këtyre mjeteve bëhet nga kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale i buxhetit të planifikuar i drejtorisë së Kulturës ,Rinisë dhe Sportit dhe miratuar nga Kuvendi i komunës, në kategorinë për Shpenzime Kapitale në projektet :

300,000.00 €

- Kodi i projektit : 10/611/850010/300/53732/0820 ‘Ndërtimi i qendrave multifunksionale (Shtëpi e Kulturës: Muze, Arkiv, Bibliotekë,Teatër,Salla Filmi, Galeria e Arteve)Glllogoc, Tërstenik,Komaran”.

.....

300,000.00 €

- Kodi i projektit : 10/611/850010/300/89114/0820 Objekte Sportive Stadioni i Qytetit- Faza e dytë

.....

Totali:


.....

300,000.00€

Shuma e mjeteve për transfer e përmendur në nenin 2 të këtij Propozim-Vendimi do të shpenzohen në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale , konkretisht në projektet e lartshënuara.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

 **KRYETARI I KOMUNËS**

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L – 048 ,Komuna e Drenasit obligohet të miratoj Vendimin për transferin e mjeteve nga Projekti “Ndërtimi i qendrave multifunksionale (Shtëpi e Kulturës: Muze, Arkiv, Bibliotekë, Teatër, Salla Filmi, Galeria e Arteve)Glllogoc, Tërstenik, Komaran” tek Projekti Objekte Sportive Stadioni i Qytetit- Faza e dytë, të cilat mjete me herët kanë qenë të planifikuara dhe të miratuara nga Kuvendi i komunës së Drenasit, për këto dy projekte kapitale ku për Projektin Objekte Sportive Stadioni i Qytetit- Faza e dytë janë nënshkruar kontratat dhe memorandum bashkëpunimi me MRKS, niveli Qeveritar i ka destinuar si kategori shpenzime kapitale, shumën e kryer projektit në vlerën prej 300,000.00€, ku bartja është nevojë themelore nga dinamika e projekteve, mungesa e mjeteve financiare ,nevoja e domosdoshme dhe kërkesa nga Federata dhe Klubi Feronikeli për përmbylljen e fazës së dytë të këtij projekti andaj transferi i këtyre mjeteve është i domosdoshëm për realizimin e këtij projekti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-400/01-16906 dt. 07.04 2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR RITJEN DHE BARTJËN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Me këtë Propozim vendim, miratohet rritja dhe bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023. Mjetet për rritje dhe bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar dhe viteve tjera.

Neni 2

Të hyrat vetanake për rritje janë në shumë prej: **1,146,544.88 euro** dhe të hyrat e pa shpenzuara e që duhet të bartën nga fondi (21) janë në shumë prej: **270,627.97 euro** dhe nga fondi burimor (22) në shumë prej: **207,435.27 euro**.

Neni 3

Totali i mjeteve për rritje dhe bartje, në shumë prej: **1,624,608.12 euro** barten në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe shërbime	298,080.27 euro
Shpenzimet Komunale	24,000.00 euro
Subvencione dhe transfere	29,835.81 euro
Investime kapitale	1,272,674.04 euro

Neni 4

Shuma e mjeteve për bartje nga neni 2, i këtij Vendimi, do të shpenzohet në këto kategori të shpenzimeve dhe në këto programe – nën programe të komunës:

Mallra dhe Shërbime:

-Zyra e Kryetarit (160) nën programi (16001) dhe kod funksional (0111) në shumë prej: 54,391.38 €
-Shërbimet e Shëndetësisë Primare (730) nën-programi (73100) dhe kod funksional (0721) në kategorinë mallra dhe shërbime (0130), në shumë prej: 6,528.00 €
- Drejtoria e planifikimit urban dhe mbrojtje të mjedisit (663) nën-programi (66310) dhe kod funksional (0610) në kategorinë mallra dhe shërbime (0130) shuma prej 19,938.48 €
- Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje civile dhe Emergjencë (180) nën-programi (18001) dhe kod funksional (0451) në shumë prej:..... 12,361.49 €
-Drejtoria e Administratës dhe personeli (163) nën-programi (16301) dhe kod funksional (0133) në shumë prej:..... 30,000.00 €
-Drejtoria e Zhvillimit ekonomik (480) nën-programi (48001) dhe kod funksional (0411) dhe shumë prej:..... 17,000.00 €
- Drejtoria për Infrastruktura Publike(181) nën-program (18161) dhe kod funksional (0451) dhe shumë prej:..... 20,000.00 €
-Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural (470) nën-program (47001) dhe kod funksional (0421) dhe shumë prej:..... 32,000.00 €
Shërbimet e shëndetësisë primare (731) nën-programi (73100) kod funksional (0721) dhe shumë prej:..... 3,861.00 €
Arsimi parafillor (922) nën-programi (92210) kod funksional (0911) dhe shumë..... 12,242.98 €
Gjithsej mallra dhe shërbime..... 204,462.33 €

Shpenzime Komunale:

Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje civile dhe Emergjencë (180) nën-programi (18001) dhe kod funksional (0451) në kategorinë e shpenzimeve Komunale, shuma prej..... 24,000.00 €
Gjithsej shpenzime komunale 24,000.00 €

Subvencione-transfere:

-Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje civile dhe Emergjencë (180) nën-programi (18001) dhe kod funksional (0451) në kategorinë e Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej.....10,485.04 €
-Drejtorati i Administratës - Shëndetësi (730) nën-programi (73010) dhe kod funksional (0760) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:..... 12,083.01 €
-Zyra e Kryetarit (160) nën-programi (16001) me kod funksional (0111) dhe shumë prej: 617.56 €
-Drejtorati i Administratës - Arsím (920) nën-programi (92005) dhe kod funksional (0980) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej: 1,150.10 €

Gjithsej Subvencione-transfere..... 24,335.71 €

Investimet Kapitale:

Në programin Shërbimet Publike dhe punë Emergjente (180) nën-programi (18001) me kod funksional (0451) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

-Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese me kod projekti (49288) dhe shumë prej:..... 5,751.00 €

Totali i Shërbimeve Publike dhe Punë Emergjente..... 5,751.00 €

Në Programin e Infrastrukturës Publike (181) nën-programi (18161) me kod funksional (0451) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

-Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci” - Drenas (49297) dhe shumë..... 1,000,000.00 €

-Rregullimi i shtratit të lumit Drenica - Verbica (48254) dhe shumë prej:..... 4,876.17 €

-Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyq (48646) dhe shuma prej 65,752.50 €

- Asfaltimi i rrugës Zabel i Ulët dhe Epërme, Korroticë e Ulët dhe Epërme (48658) dhe shumë prej:..... 51,296.90 €

-Kanalizimi i ujërave të zeza Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Ulët (48705) dhe shumë prej: 5,109.00 €

-Kanalizimi i ujërave të zeza Gllanasellë dhe Godanc (48710) dhe shumë prej: 6,344.14€

-Kanalizimi i ujërave të zeza Negroc, Kizhnarekë (48713) dhe shumë prej:4,669.00 €

-Kanalizimi i ujërave të zeza Shtuticë, Verbovc dhe Polluzhë (51323) dhe shumë prej:1,933.50€

Totali i infrastrukturës Publike në shumë prej 1,139,981.21 €

Në programin Drejtoria e Kulturës dhe sportit (850) nën-programi(85001) dhe kod funksional (0820) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

-Fushat sportive dhe rekreacionit (49183) dhe shuma prej 18,642.60 €

Totali i Drejtorisë së Kulturës dhe sportit..... 18,642.60 €

Totali i investimeve kapitale..... 1,164,374.81 €

Investimet kapitale

Mjetet për bartje nga fondi burimor (22) në kategoritë ekonomike të shpenzimit Investime Kapitale

Në Programin e Infrastrukturës Publike (181) nën-programi (18161) dhe kod funksional (0451) do të bartën këto mjete sipas projekteve kapitale:

- Zgjerimi i Sheshit "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci" me kod (49297), shuma prej:... 107,520.10 €

Administrata e Arsimit (920) nën-programi (92005) dhe kod funksional (0980) do të barten mjetet:

-Riparimi i nxemjeve qendrore, me kod (49197) shuma prej:779.04 €

Totali i Investimev kapitale nga fondi burimor (22) shuma prej:.....108,299.23 €

Mallra dhe Shërbime

Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe pronë (650), nën-programi (65005), kod funksional (0610) dhe shumë prej:..... 74,665.68 €

Drejtoria e Administratës dhe Personelit (163), nën-programi (16301), kod funksional (0133) dhe shumë prej:..... 2,806.42 €

Drejtoria për Planifikim Urban dhe mbrojtje të mjedisit (663), nën-program (66310), kod funksional (0620), shuma prej:..... 458.52 €

Shërbimet Primare shëndetësore (731) nën-programi (73100), kod funksional (0721) dhe shumë prej:..... 108.00 €

Arsimi Parafillor (922) nën-programi (92210), kod funksional (0911), shuma prej:....15,579.32 €

Totali i mallrave dhe shërbimeve nga fondi burimor (22), shuma prej:.....93,617.94 €

Subvencione dhe Transfere

Drejtoria për Shërbime Publike dhe punë emergjente (180), nën-programi (18001), kod funksional (0451), dhe shumë prej:..... 4,168.20 €

Drejtoria e Administratës Arsim (920), nën-programi (92005) kod funksional (0980) dhe shuma prej:..... 1,349.90 €

Totali i subvencioneve nga fondi burimor (22) shuma prej:..... 5,518.10 €



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci